



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 17.03.2025
Numër protokolli: 1754/2025

A.nr.187/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtar, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.187/2025 të datës 23.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.T,kundër organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.187/2025, të datës 23.01.2025, të parashtruar nga ankuesi A.T.

A r s y e t i m

Ankuesi A.T. (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), kandidat për pranim në shërbimin civil sipas Konkursit Nr. Reference: RN00015136 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, i shpallur nga Inspektoratit i Punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Nga provat e administruara, rezulton se Inspektorati i Punës ka shpallur Konkursin me datë 13.09.2024 me Nr. referencës RN00015136 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, klasa profesional 1, numri i kërkuar 7, me afat aplikimi nga data 14.09.2024 deri më datë 13.10.2024.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, ndërsa Komisioni i Pranimi në Inspektoratin e Punës ka publikuar Njoftimin me datën 24.12.2024 për kandidatet fitues, për pozitën *“Inspektor i Punës”* Rajoni i Prizrenit.

Kundër Njoftimit të datës 24.12.2024 të Komisionit të pranimi në Inspektoratin e Punës ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 23.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.74/2025, të datës 13.01.2025, dhe për pasojë është **anuluar** Konkursi me numër Nr. Reference: *RN00015136 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës*, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, i shpallur nga Inspektorati i Punës, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.74/2025, të datës 13.01.2025, është anuluar Konkursi me numër Reference: *RN00015136 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës*, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, i shpallur nga Inspektorati i Punës, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë. Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.187/2025, të datës 23.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative,

brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.187/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit; A.T;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.